Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/497
Datë:01.08.2024

Në mbështetje të neneve 8, 9 dhe 16 të Ligjit Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr. 28/2014, për Kriteret dhe Procedurat për Verifikimin e Standardit të Profesionit, si dhe bazuar në nenin 5 paragrafi 4, 5 dhe 6 si dhe nenit 6 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 01/196 e punës e Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 25.07.2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. **Nuk Aprovohet** Standardi i Profesionit me emërtim "Instruktorët e vozitjes" dhe me kod 5156.

2. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Bazuar në dispozitat ligjore në fuqi nga fushëveprimtaria e Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, Këshilli për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe për të Rritur, i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (KAAPRr/MASHT), ka dorëzuar në AKK aplikacionin për verifikimin e standardit të profesionit "Instruktorët e Vozitjes" me kod 5156.
Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve bazuar në nenin 6 paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr. 28/2014, për Kriteret dhe Procedurat për Verifikimin e Standardit të Profesionit, ka përzgjedhur ekipin e ekspertëve të cilët kanë realizuar procesin vlerësues për verifikimin e standardit të profesionit si me lartë. Ekipi i ekspertëve vlerësues pas vlerësimit të standardit të profesionit "Instruktorët e Vozitjes", bazuar ne nenin 6 paragrafi 1 pika 1.4 Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr. 28/2014, për Kriteret dhe Procedurat për Verifikimin e Standardit të Profesionit kanë hartuar raportin për verifikimin e standardit të profesionit dhe i njëjti me datë 25.07.2024 është proceduar në Këshill Drejtues të AKK-së për vendimmarrje. Ekipi i ekspertëve në raportin vlerësues pas procesit për verifikimin e standardit të profesionit i kanë rekomanduar Këshillit Drejtues të AKK-së mos aprovim të standardit të profesionit "Instruktorët e Vozitjes" bazuar në të gjeturat nga procesi vlerësues dhe kanë konstatuar se: mungon analiza e tregut të punës, mungojnë të dhënat e palëve të interesit të cilat janë përfshirë në zhvillimin e standardit,

mungojnë të dhënat për përfaqësimin e ekipit zhvillues si dhe mungojnë referencat në të cilat është mbështetur zhvillimi i standardit.

Andaj, Këshilli Drejtues i AKK-së në bazë të kërkesës së KAAPRr për verifikim të standardit të profesionit "Instruktorët e vozitjes", rekomandimeve përfundimtare të ekipit të ekspertëve të dhëna në raportin për verifikimin e standardit të profesionit, pas shqyrtimit dhe analizimit të raportit, si dhe nga të lartcekurat vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë, sipas nenit 125 dhe 126 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit kompetent, në afat prej 30 ditësh nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ, sipas nenit 127 të LPPA.

Vendimi u dërgohet:

1. KAAPRr.-së;
2. Arkivit të AKK-së.

Dr. Besim Mustafa

Kryetar i KD të AKK-së